



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:148075  
Datë: 21.03.2024  
Numri i dokumentit: 05485716

**C.nr.222/2012**

**GJYKATA THEMELORE G. – DEGA VITI**, gjyqtari Alush Sinani, në çështjen kontestimore të paditësit H.H.nga fshati P. Komuna e V., kundër të paditurit S.R. nga fshati P. Komuna e V., te cilin me autorizim e perfaqeson A.I.avokat ne G., me objekt kontesti kompenzimi i damit material, me datë 19.03.2024, mori këtë:

#### **AKTVENDIM**

I. Ndërpritet procedura në çështjen kontestimore të paditësit H.H.nga fshati P. Komuna e V., kundër të paditurit S.R. nga fshati P. Komuna e V., te cilin me autorizim e perfaqeson A.I.avokat ne G., me objekt kontesti kompenzimi i damit material, për shkak të zgjidhjes së ështëjes paraprake.

II. Procedura e ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 278 paragrafi 1 pika a) të LPK-së. do të vazhdojë pas propozimit të palës paditëse.

#### **Arsyetim**

Paditësi H.H.nga fshati P. Komuna e V., me datë 14.08.2012 , në këtë gjykatë kanë ngritur padi kundër të paditurit S.R. nga fshati P. Komuna e V., me objekt kontesti kompenzimi i damit material.

Gjykata këtë çështje juridike civile, ka mbajtur disa seanca gjyqësore, ndërsa në seancën e datës 19.03.2024, paditësi, ka propozuar që procedura lidhur me këtë çështje kontestimore të ndërpritet, pasi që çështja e kompensimit të dëmit, që është objekt i kësaj padie është e lidhur me ngastrën kadastrale (816/7), që sipas meje e kam të drejtën e parablerjes së asaj ngastre të cilën e kam shfrytëzuar një kohë të gjatë, në të njejtën ngaster ka mbjellur 20 trungje pemë të ndryshme, mirëpo, i padituri të njejtat-pemët i ka prerë, ka marrë nga ajo ngastër 20 kamionë me dhe poashtu ia ka dëmtuar edhe disa gypa të betonit, meqenëse, procedura në çështjen kontestimore që ka të bëjë me parablerjen e ngastres në fjalë, nuk ka përfunduar , kështu që gjykatës i ka propozuar që procedura lidhur me këtë padi që ka të bëjë me kompensim dëmi të ndërpritet derisa të vendoset në mënyrë meritore dhe me vendim të formës së prerë çështja e vërtetimit të pronësisë mbi bazën e përparësisë në blerje të ngastrës kontestuese.

Përfaqësuesi i të paditurit, avokati Arton Ibrahimimi në seancën pregaditore të datës 19.03.2024, ka deklaruar se n parim, e kundërshtojmë këtë propozim, ngase konsiderojmë se për të vërtetuar një kompensim dëmi, siç pretendon paditësi, i njejt i duhet të ofrojë prova lidhur me dëmin, të përcaktojë vlerën e këtij dëmi, mirëpo, ndersa lidhur me propozimin për nderprejen e procedurës, ia lëmë gjykatës të vendosë.

Pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe deklarimit të palëve ndërgjyqëse, perkatsisht propozimit të palës paditëse gjykata konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore që bazuar në nenin 278, paragrafi 1. pika a), lidhur me nenin 13, të LPK-së, të ndërpritet procedura kontestimore, për shkak të zgjidhjes së ështëjes paraprake.

Në këto rrethana, duke u mbështetur në nenin 278, paragrafi 1. pika a), ku është përcaktuar se: “Procesi gjyqësor ndërpritet: a) po që se ka vendosur që vetë të mos e zgjidhë ështëjen paraprake (neni 13 i këtij ligji)”, procedura-gjykimi do të vazhdojë pasi të përfundojë procedura në formë të prerë tek gjykata , prandaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 280 paragrafi 3 të LPK-së

**GJYKATA THEMELORE G. - DEGA E GJYKATËS VITI**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PËR ÇËSHTJE CIVILE**  
**2019:148075, 19.03.2024**  
**C.nr. 222/2012**

**Gjyqtari,**  
Alush Sinani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afatin prej 15 ditëve, në Gjykatën e Apelit. Ankesa eventuale në kopje të mjaftueshme dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.